
RECENSIONE

**TEKI SELENICA: "SHQIPËRIA MË 1927",
Shtypshkronja "Tirana", 1928 dhe ribotim Shtëpia Botuese "Pegi",
Tiranë, 2002, 573 f.**

Për jetën e shtetit të pavarur shqiptar, e cila filloi pas Shpalljes së Pavarësisë më 1912, janë botuar libra, monografi historike, politike, ekonomike, arsimore e kulturore. Midis tyre zë një vend të rëndësishëm edhe libri i Teki Selenicës me titull "Shqipëria më 1927", i botuar para 80 vjetësh.

Duhet thënë që në fillim se për nga informacioni që sjell kjo vepër, për nga metoda shkencore që ka përdorur autori në hartimin e këtij libri, si dhe për nga vështirësitë e realizimit të botimit, në kushtet teknike të kohës në Shqipëri, – libri "Shqipëria më 1927" përbën një vepër shumëdimensionale të karakterit të mirëfilltë shkencor dhe një burim të pazëvendësueshëm historiografik për të gjithë studiuesit që merren me studime për Shqipërinë dhe shqiptarët.

Në tërësinë e tij, libri mund të duket i zakonshëm, në përqasje me botime të tjera të kësaj natyre, por, për nga larmia dhe besueshmëria e informacionit nga të gjitha fushat e jetës shqiptare të kohës, përbën një veçori të dukshme qartë me vlera të përhershme burimore.

Për nga lënda që shtjellohet në këtë libër, si në formë e në përmbajtje, ai nuk qëndron aspak prapa botimeve të tilla të shteteve moderne të kohës. Autori është mbështetur fuqimisht, siç e ka thënë edhe vetë në parathënie, pikërisht në veprat e autorëve më të njohur të vendeve të zhvilluara perëndimore, shembull orientues edhe për shtetin shqiptar. Këtë e tregon më së miri lista e botimeve bibliografike të njohura e me autoritet, të autorëve vendas dhe të huaj, që nga Sami Frashëri, Mit'hat Frashëri, Lef Nosi, Kosta Çekrezi, Fan Noli, Turhan Pasha e deri tek Degrand, Herbert, Luis, Godard, Ugolini, Rei, Jorga etj., si dhe mjaft botime dokumentare ndërkombëtare.

Në mënyrë të veçantë autori dallon si model veprat më të famshme të burimit francez: "Annuaire gjeneral", Larouss"-in etj.

Me të drejtë autori veçon si punë krijuese të mirëfilltë në këtë vepër, pjesën historike, që përfshin ngjarjet mbas independencës kombëtare. Për nga mbështetja në dokumente dhe në fakte të shëndosha, kjo pjesë e librit është tepër e arrirë, që mund të konsiderohet si një burim i rëndësishëm për historinë politike të Shqipërisë. Deri në kohën që u botua ky libër, pra deri më 1928, nuk kishte ndonjë vepër politike të historisë kombëtare, për jetën e tij të pavarur ku të shtjelloheshin të gjitha ngjarjet e peripecitë e historisë tonë për periudhën 1912-1929.

Në hartimin e këtij libri, sidomos të anës statistikore të tij, autori vërtetë ka shfrytëzuar shkolla të ndryshme të huaja, por ai ka bërë një punë krijuese që, siç thotë vetë ai, “shumë më të perfeksionuar”. Ai nuk është mjaftuar vetëm me shifra e tablo, por i ka shpjeguar, i ka analizuar, i ka krahasuar dhe ka treguar kurdoherë lidhjen midis tyre duke dhënë dhe rezultatin.

Teki Selenica i ka bërë një vlerësim lapidar rolit të statistikës për ekzistencën shtetërore të një kombi dhe për të zënë vendin e duhur në skenën ndërkombëtare. “Statistika e ndjek njerinë si një shok besnik, e cila fillon që në djep dhe i jep fund veprës në varr, ajo shënon çdo gjë që sheh njeriu mbi valët e shkumëzuara të jetës”. Në këtë kontekst ai ka vlerësuar veprën e tij, e cila i hapte një shteg kombit shqiptar për të qenë në skenën ndërkombëtare të diturisë.

Për vlerat shumëdimensionale të kësaj vepre mund të flasim specialistë të veçantë, sipas fushave përkatëse. Unë do të ndalem në atë pjesë ku trajtohet “Shqipëria historike” që zë rreth 168 faqe të librit.

Në përmbajtjen e kësaj pjese, e cila përbën një sintezë të ngjeshur të historisë së shqiptarëve, përfshihet historia nga origjina pellazgjike e tyre dhe deri në shpalljen e Republikës Shqiptare, në tre vitet e para të jetës së saj. Natyrisht, pjesa më e madhe i takon historisë së ngjarjeve që lidhen me Shpalljen e Pavarësisë dhe të krijimit të shtetit të parë shqiptar (rreth 145 f.)

Trajtimi i ngjarjeve, proceseve historike si dhe e figurave historike, ndonëse në një volum relativisht të kufizuar, është bërë në mënyrë objektive e realiste. Aty kanë zënë vend për çdo periudhë historike ngjarjet dhe figurat historike më kulmore dhe, në raport me të, janë shtjelluar gjithë zhvillimet historike. Në faqet e kësaj pjese të “Shqipërisë historike”, jo vetëm lexuesi i thjeshtë, por edhe mjaft studiues, të rinj e të vjetër të sotëm, do të gjenin material për ngjarje e figura historike të panjohura ose të njohura pak. Mund të kuptohet lehtë se autori i saj është i zhveshur nga komplekse politike të njëanshme e tendencioze të trajtimit të historisë, sëmundje kjo që u vu re në historiografinë tonë të gjysmës së dytë të shek. XX.

Në mënyrë të veçantë trajtimi objektiv historik i ngjarjeve nga autori, bie në sy në ngjarjet pas Shpalljes së Pavarësisë dhe krijimit të shtetit shqiptar të pavarur. Duke e vlerësuar krijimin e shtetit të pavarur shqiptar si një fitore historike për përparimin dhe prosperitetin e kombit shqiptar, autori vlerëson ngjarjet dhe qëndrimet e individëve në raport me këtë shtet, në kuptimin se sa ndihmon secili prej tyre forcimin apo në dobësimin e tij. Shteti shikohet nga autori si një element i fuqishëm të ekzistencës së një kombi, ndaj të cilit duhet të kontribuojnë të gjithë në forcimin e tij, për një shoqëri të organizuar e për t’u rreshtuar në rendin e kombeve të përparuar. Nëpërmjet shtetit, Shqipëria do të zgjidhte problemet më të rëndësishme të saj, që lindnin në organizimin e shoqërisë moderne shqiptare, në të gjitha fushat e jetës së saj, por edhe në

raport me fqinjët dhe në marrëdhëniet me vendet e tjera të botës, në pjesëmarrjen e Shqipërisë në forumet e organizatat ndërkombëtare.

Administrata e shtetit shqiptar në të gjitha nivelet e tij prezantohet me detaje dhe me saktësi në librin e Teki Selenicës, për ta radhitur Shqipërinë në familjen e shteteve sovraane e dinjitoze të kohës. Autoriteti i shtetit, sidomos për Shqipërinë e sapolindur në skenën politike botërore, si i tillë, kishte për autorin T. Selenica rëndësi të dorës së parë.

Në këtë kontekst autori ka analizuar dhe lëvizjen rebele të Shqipërisë së Mesme të vitit 1914, e cila kërkonte “Babën” që kish vdekur, si një lëvizje fanatike që “po shkurtonte jetën kombëtare”. Burimin e kësaj lëvizjeje rebele autori e kërkonte në intrigat sllavo-greke me anën e Esat Pashës e njerëzve të tij, në intrigat direkte të tyre që vepronin me anën e dhaskalëve, priftërinjve dhe konsullatave, si dhe në intrigat e turqve të rinj, të lindura në vend prej fanatizmës fetare e që vepronin me njerëzit e tyre.

Tek lexon këtë trajtim realist e objektiv të ngjarjeve, në një botim të dhjetra vjetëve më parë, duket diçka e çuditshme që historiografia jonë e mëpasme, për këto ngjarje, nuk e ka thënë akoma të qartë fjalën e saj, por noton në pikëpamje të dyzuara. Referenca tek libri i T. Selenicës për këtë ngjarje të historisë kombëtare dhe për ngjarje të tjera të mëvonshme, do t'i jepte çdo historiani çelësin e zgjidhjes së problemit, të zhvillimit historik të mëvonshëm të shtetit shqiptar.

Në këndvështrimin e dëmit të madh ndaj shtetit, autori Teki Selenica analizon dhe trajton ngjarjet politike të viteve 1920-1924. Luftën e brendshme politike në vitin 1924, për të marrë një kolltuk në pushtet, ai e quante shumë të rrezikshme sepse “grupet e opozitës në këtë zjarr, po digjnin jo Partinë Popullore në pushtet, por në prushin e këtij zjarri po përvëlonin sentimentin për shtet”, për atë shtet që kishin nevojë më shumë shqiptarët, që sapo kishin hedhur themelet e tij e që duhej konsideruar si imperativ i kohës, që kërkonte mbështetje të fuqishme. Sa anakronike tingëllonte betimi mbi varrin e të vdekurit më 1924, “Ja neve në fuqi..., ja Shqipëria gur e hi”, kur mendon se përballë nuk ishin pushtuesit e huaj, por shteti shqiptar, për të cilin ishin sakrifikuar aq shumë shqiptarët, për ta ndërtuar në Kongresin Kombëtar të Lushnjës.

Nisur nga ngjarjet që i paraprinë Revolucionit të 1924-ës, autori i librit “Shqipëria më 1927”, vendos një paralele me veprimin e rebelëve më 1914, duke e cilësuar revolucionin “një provë fatale mbas 10 vjetëve të përsëritur në dëmin e shtetit”.

Me fakte e dokumente zyrtare të kohës, ndoshta për herë të parë, hidhet dritë për anarkinë totale në të cilën u zhyt vendi, pas vendosjes së qeverisë së Nolit. “Vendi ishte në një anarki të plotë, kurrkundi nuk ndihesh, as era e autoriteti qeveritar. Ishte bamun një bindje gati e përgjithshme se jeta e regjimit ... nuk do ta mbushte muajin” (M. Kruja në raportin e tij nga Shkodra më

9.09.1924). Kështu shkruante Teki Selenica në libër, duke iu referuar dokumenteve të kohës.

Kundërshtarët politikë u përdoqën me gjyqe politike, me internime, me burgosje, me djegie e shkatërrim shtëpish të tyre. Sikur të mos mjaftonin këto masa, autori trajton në libër dhe masa akoma më të rrepta. Propozohet që shqiptarët e ndodhur jashtë kufirit të Shqipërisë, duhet të largoheshin 200 km larg kufirit. Në rast të kundërt, fëmija i tyre do të internohej në një vend të caktuar, sipas vendimit të këshillit ministror (f.134). U dhanë urdhra për burgosje për të gjithë ata që bënë propagandë demoralizuese si dhe për ahmedistët (mbështetësit e A. Zogut - M.D.) (urdhër i zv. Ministrit të Punëve të Brendshme Xhemal Bushati, më 13.12.1924).

Nëpërmjet këtij libri lexuesi njihet me fakte të panjohura që historiografia e mëparshme i ka mënjanuar. Duke e idealizuar atë periudhë historike 6-mujore, ajo ka zbehur anarkinë totale të cilën e përjetoi Shqipëria në planin e brendshëm dhe atë të jashtëm.

Ardhjen e Ahmet Zogut në dhjetor 1924 e pasqyron si një domosdoshmëri për të shpëtuar vendin nga anarkia e shturja. Ai i ishte gjendur Shqipërisë në momentet, kur rreziku kishte qenë më evident: më 1916, kur kishte përgatitur Kryesinë e Elbasanit më 1920, në Kongresin e Lushnjës, në luftën e Koplikut, kur kishte shpëtuar shtetin gjatë grushtit të dhjetorit 1921, në përballimin e kryengritjes së marsit 1922 etj.

Në veprën e Teki Selenicës kanë gjetur kanë gjetur trajtim ngjarje të një rëndësie të madhe për mbarëvajtjen e shtetit, siç ishte Kuvendi i Besës Shqiptare, më 26 qershor 1925, ku u lidh besa me krerët e parisë së disa krahinave, për të qenë kurdoherë të bindur e besnik në ligjet e shtetit. Kjo besë do t'i shërbente Ahmet Zogut, Presidentit të Republikës, për ta shfrytëzuar gjatë çarmatimit të përgjithshëm në ato zona, ku popullit i ishte kthyer ndjenja e shtetit me gjithë kuptimin e fjalës.

Në librin e Teki Selenicës kanë zënë vend fakte historike të rëndësishme, të cilat dëshmojnë për vizionin e qartë të Presidentit të Republikës në drejtim të bashkimit kombëtar. I tillë ishte, ndër të tjera, dekretimi i faljes së përgjithshme më 20 tetor 1925, për të gjithë të arratisurit politikë, “për t’u kthyer e t’i shërbenin vendit të tyre, dhe të mos bëheshin agjentë të shteteve të huaja”.

Libri që kemi në duar u ka dhënë përgjigjen e saktë dhe të plotë çështjeve të marrëdhënieve midis Shqipërisë e fqinjëve, të cilat nuk janë marrë në konsideratë nga historiografia shqiptare e gjysmës së dytë të shek. XX. Kështu, çështja e Shën Naumit është trajtuar mjaft e argumentuar, si një transaksion në favor të Republikës Shqiptare dhe jo një tradhti, siç deklaroi në arratisurit politikë në kuadrin e propagandës kundër Ahmet Zogut. Kujtojmë këtu deklaratën e Mehdi Frashërit që iu përgjigjej akuzave të kundërshtarëve: “Qeveria shqiptare asnjë pëllëmbë tokë nuk humbiste, por përkundrazi kundrejt ndërtesës së Shën Naumit, që nuk kishte asnjë banor, merrte katundin Peshkëpi

me 60 shtëpi e me 300 frymë, fushën e Çeravës, kishën e Ajazmës dhe kodrat strategjike të Shën Naumit” dhe fitonte një tokë prej 22 km² duke larguar kufinin 25 km” (f. 151).

Me marrjen në dorëzim të tokave të zonës së Peshkëpisë, më 27 nëntor 1925, shteti shqiptar vuri nën sovranitetin e tij të gjithë sipërfaqen e vendit, të caktuara prej Konferencës së Londrës, duke mbyllur një proces që zgjati nga viti 1912 – deri më 1925. Ishte ky një rezultat domethënës i një prej arritjeve të autoritetit të shtetit shqiptar, në forcimin e pozitës ndërkombëtare të tij.

Libri i Teki Selenicës, me informacionin e saktë që sjell për Shqipërinë dhe shtetin shqiptar të para 83 vjetëve, mund të konsiderohet si një enciklopedi më vete, për periudhën që ka bërë objekt të studimit. Ky burim historiografik, tashmë, po bëhet burim themelor referimi për studimet e ndryshme të kryera në vend, në fusha të ndryshme, jo vetëm të karakterit historik, por edhe shumë më gjerë.

Muharrem DEZHGIU

